

Apostujt Evodi e Onisifori nga të 70-t. Dëshmor Sozoni (Sozonti). Oshënare Kasiania, himnografe.



E enjte, 7 shtator 2023 – Shenjtori i ditës.

Apostujt Evodi e Onisifori nga të 70-t. Dëshmor Sozoni (Sozonti). Oshënare Kasiania, himnografe.

- APOSTUJT EVODI E ONISIFORI NGA TË 70-t -

Shën Evodi ishte një nga shtatëdhjetë dishepujt e Zotit dhe episkop i parë i Antiokisë, i caktuar nga apostulli Petro kur u largua për në Romë. Thuhet se ne ia detyrojmë Evodit mbiemrin “i krishterë” për anëtarët e Kishës (Vep. 11.26). Shën Ignati, pasuesi i tij në fronin e Antiokisë, në një nga letrat që i drejton grigjës shkruan: “Kujtoni Evodin e bekuar, bariun tuaj, që ishte i pari pas apostujve që pati përgjegjësinë e kishës suaj. Tregojeni veten të denjë për një atë të tillë dhe mos u bëni si fëmijët që vijnë nga shkelja e kurorës”.

Evodi e udhëhoqi grigjën e Zotit me urtësi, e ruajti veten të pathyer nga bota dhe pastaj u largua në paqe drejt banesave të të drejtëve. Disa thonë se vdiq si martir në kohën e Neronit (viti 64 pas Krishtit) ose pak kohë më vonë.

Shën Onisifori përmendet me mirënjohje nga shën Pavli në letrën e dytë drejtuar

Timotheut: “Zoti dhëntë përdëllim në shtëpinë e Onisiforit, sepse shumë herë më dha zemër dhe s’pati turp prej hekurave të mi, por kur erdhi në Romë, më kërkoi me shumë ngulm dhe më gjeti. Zoti i dhëntë atij të gjejë përdëllim nga Ai në atë ditë. Dhe sa më shërbeu në Efes, ti e di mirë” (II Tim. 1.16-18).

Shën Onisifori u bë episkopi i parë i Kolofonit në Azinë e Vogël dhe qëndroi besnik në besimin dhe në predikimin e Lajmit të Mirë, madje edhe duke derdhur gjakun e tij.

* * * * *

- DËSHMOR SOZONI (Sozonti) -

Shën Sozoni lindi në Likaoni të Azisë së Vogël dhe jetoi në mbretërimin e Dioklecianit (284-305). Ai quhej Taras para se të pagëzohej dhe kishte qenë barí. Ai shkoi më tej duke mësuar artin e kullotjes së grigjës shpirtërore dhe solli në besën e vërtetë një numër të madh paganësh me anë të mësimit të tij.

Një ditë, atij iu shfaq në një vizion se kishte mbërritur koha që të derdhte edhe gjakun e tij duke pohuar Krishtin. Kështu ai zbriti në Pompeipolis në Kiliki dhe hyri në tempullin e idhujve ku adhurohej një statujë e artë e Artemisë. Ai i preu dorën e djathë dhe e copëtoi në copëza të vogla për t’ua ndarë të varfërve. Paganët u zemëruan tej mase kur vunë re se çfarë kishte ndodhur dhe u turbulluan edhe më shumë kur panë se Sozoni i bekuar, u dorëzua vetë për të larguar çdo lloj dyshimi. Ai u paraqit menjëherë përpara Maksimianit, guvernatorit të Kilikisë.

Kur shigjetat nuk arritën dot të përkulin vullnetin e tij të fortë për të pohuar Krishtin, atëherë e detyruan të vrapojë me sandale hekuri me gozhdë nga brenda. Kur pa gjakun t’i rridhte në tokë si shi bamirës, shenjtori u mbush me gëzim të madh që nuk ishte i kësaj bote, po që e pati derisa e dorëzoi shpirtin në duart e Perëndisë, i goditur pa mëshirë dhe aq fort, sa i dukeshin kockat dhe të përbrendshmet. Kur ekzekutorët ndezën zjarrin për t’i djegur trupin, nisi një stuhi e madhe, shiu e shoi zjarrin dhe paganët u larguan me vrap të tmerruar. Të krishterët patën mundësi të merrnin trupin e martirit të shenjtë.

* * * * *

- OSHËNARE KASIANIA, HIMNOGRAFE -

Oshënare Kasiania (Himnografja) jetoi në shek. IX në Konstandinopojë, në kohën e mbretit Theofil.

Teksa rritej në moshë, krahas bukurisë fizike kishte mjaft mençuri e urtësi. Sipas kronikanëve bizantinë të kohës, ndër ta dhe shën Simeon Metafrastit (9 nëntor), thuhet se mori pjesë në ceremoninë e përzgjedhjes së nuses për perandorin Theofil, të organizuar nga e ëma e tij, Efrosina.

Theofili, i magjepsur nga bukuria e Kasianisë, iu afrua e i tha: “Nga gruaja erdhi mëkati”, duke iu referuar rënies së Evës në Eden. Kasiania e urtë iu përgjigj: “Nga gruaja erdhi edhe shpëtimi”, shpëtimi që solli Perëndia i mishëruar, i Cili erdhi në

botë prej Hyjlindëses. Perandorit të ri iu prek sedra dhe nuk zgjodhi Kasianinë për grua, por Theodhorën.

Kasania e kaloi pjesën tjetër të jetës në një manastir (kinov), të cilin e themeloi vetë në perëndim të Konstandinopojës, pranë mureve të qytetit. Igumene e manastirit u bë ajo vetë.

Në vitin 843, teksa Kasania po hartonte himnin e saj të famshëm, që këndohet të Martën e Madhe të Shenjtë, Perandori Theofil, i cili nuk kishte reshtur së dashuri shenjtoren shkoi në manastirin ku ajo qëndronte, me dëshirën për ta parë edhe një herë të fundit. Sapo dëgjoji trokëllimën e kuajve të shpurës ushtarake, Kasania, pavarësisht se edhe ajo e kishte mjaft përzemër perandorin, shkoi dhe u fsheh, duke e mohuar plotësisht veten dhe dëshirat e saj.

Kur Theofili hyri në qelinë e saj dhe e gjeti bosh, qau hidhur duke thënë se si në një moment, nga krenaria e tij e kishte humbur mundësinë që të martohej me Kasianinë. Në tryezën e saj gjeti himnin e papërfunduar, dhe thuhet se një pjesë të tij e plotësoi ai vetë.

Shenjtoria e përfundoi jetën tokësore në ishullin Kasos, ku ruhet dhe lipsani i saj.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)